



DATA MARRJES 17.05.2012

N. PROT 427

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 304 , datë 9.5.2012

P Ë R

PËRBËRJEN DHE DETYRAT E KOMISIONEVE TË REGJISTRIMIT
TË PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE BUJQËSORE
NË BASHKI DHE KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të nenit 12, të ligjit nr.10201 datë 17.12.2009, “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”, me propozimin e ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Përbërja e komisionieve të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore në bashki/komuna

1. Komisioni i regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore në bashki kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga këta anëtarë:
 - i. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile;
 - ii. Drejtori (përgjegjësi) i zyrës së shërbimeve sociale ;
 - iii. Përgjegjësi i zyrës së urbanistikës;
 - iv. Një përfaqësues i INSTAT-it.
2. Komisioni i regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore në komunë kryesohet nga kryetari i komunës dhe përbëhet nga këta anëtarë:
 - i. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile;
 - ii. Drejtori (përgjegjësi) i zyrës së shërbimeve sociale;
 - iii. Përgjegjësi i zyrës së urbanistikës;
 - iv. Një përfaqësues i INSTAT-it.

II. Detyrat e komisionit të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore në bashki/komuna

Në zbatim të detyrimeve ligjore, të përcaktuara në ligjin nr.10 201, datë 17.12.2009, "Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore", të nenit 12, shkronja "d", dhe udhëzimeve të Institutit të Statistikave (INSTAT), komisioni i regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore në bashki e komuna, ushtron detyrat e mëposhtme:


1. Miraton programin e punës së komisionit të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore të bashkisë/komunës, si për fazën përgatitore ashtu dhe për atë përfundimtare;
2. Emëron anketuesit e përzgjedhur në bazë të kriterëve të kualifikimit, të hartuara nga INSTAT-i;
3. Organizon punën për trajnimin e anketuesve (siguron ambientet për trajnimin dhe të gjitha mjetet e tjera të nevojshme logjistike);
4. Organizon punën për ofrimin e asistencës teknike për anketuesit, nëpërmjet ekspertëve dhe profesionistëve të tjerë të INSTAT-it, në përputhje me vlerësimet në terren dhe nevojat e paraqitura prej tyre;
5. Organizon inspektime periodike, në bashkëpunim me kontrollorët, gjatë procesit të anketimit dhe ndjek në vazhdimësi, nëpërmjet mbikëqyrësve dhe kontrollorëve, mbarëvajtjen dhe cilësinë e regjistrimit, me qëllim plotësimin e standardeve të përcaktuara nga legjislacioni, si dhe metodologjitë e udhëzimet e INSTAT-it për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore;
6. Raporton pranë komisionit të regjistrimit në qark dhe në INSTAT lidhur me ecurinë e procesit të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore;
 - a) një herë në javë, gjatë periudhës përgatitore, dhe
 - b) çdo ditë, në periudhën e regjistrimit;
7. Organizon punën në bashkëpunim me punonjësin e INSTAT-it, në nivel bashkie/komune, dhe me komisionin e regjistrimit në qark për sigurimin e mjediseve të nevojshme e të përshtatshme, marrjen në dorëzim dhe magazinimin e pyetësorëve e të materialeve të tjera shoqëruese, në mënyrë të sigurt dhe për aq kohë sa është e nevojshme për procesin e

regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore në të gjithë territorin e njësishë vendore;

8. Siguron ambientet e nevojshme për koordinimin e punës ndërmjet anketuesve, kontrollorëve e mbikëqyrësve për të realizuar plotësimin me cilësi të anketave dhe zgjidhjen e problemeve të tjera që lindin gjatë procesit të regjistrimit në terren;
9. Organizon procesin e ruajtjes dhe të dorëzimit të materialeve të regjistrimit në afatin e përcaktuar nga INSTAT-i.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

**MINISTRI PËR INOVACIONIN DHE TEKNOLOGJINË
E INFORMACIONIT E TË KOMUNIKIMIT**

GENC POLLO

